

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
KORÇE

Korçë, me 28.02.2023


SHPALLJE VENDIMI

**Drejtuar : Njesise Administrative Libonik Bashkia
Maliq**

Per: shtetasin : Ardian Ago, me adrese Drithas Njesia
Administrative Libonik Bashkia Maliq

Bashkalidhur po ju dergojme shpalljen per vendimin civil
nr. 98 dt. 06.02.2023 per t'u afishuar nga ana Juaj njoftimi
me shpallje me afat *20 ditor*, pasi deftesa e komunikimit
eshte kthyer me shenimin : " larguar " dhe pas afishimit
kjo shpallje te na kthehet e konfirmuar me vule e firme, ne
gjkate.

**KANCELARE
Geralda Kasuli**



U afishua sot ne date -----

Per Njesise Administrative Libonik Bashkia Maliq

(emer, mbiemer, firme)

K. A. Libonik
2-tei Informuesat ✓
dt 03.03.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
KORÇË

Nr.Regj.Them. 21001-01877-41-2022(760/1537)
Data e regjistrimit 22.12.2022

Nr. vendimi 41-2023-365(98)
Datë vendimi 06.02.2023

V E N D I M
"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë e përbërë nga:

GJYQTARE - Gentiana Shukullari

asistuar prej sekretares gjyqësore Brilda Hoxhallari, në Korçë, sot në datë 06.02.2023, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen civile me nr. regj. them. 21001-01877-41-2022(760/1537) datë 22.12.2022 që iu përket:

PADITËS:

Enkelejda Ago, e bija e Spiro dhe Mirjeta, dtl. 28.06.1976, lindur në Maliq dhe banuese në Drithas, Njësia Administrative Libonik, Bashkia Maliq, përfaqësuar me prokurë të posaçme, nga av. Arlind Hoxha, me adresë kontakti për efekt njoftimi: Rr."Abdyl Frashëri", Pll.3, H.3, Tiranë, tel. 0685977422.

I PADITUR:

Ardian Ago, i biri i Ibrahim dhe Lirije, dtl. 08.08.1969, lindur dhe banues në Drithas, Njësia Administrative Libonik, Bashkia Maliq, tel. 00306976384457.

OBJEKTI:

Zgjidhjen e martesës ligjore.
Pas zgjidhjes së martesës paditësja të mbajë mbiemrin aktual "Ago"

BAZA LIGJORE:

Nenet 129, 132 e vijues i K.Familjes, neni 358 e vijues i K.Pr. Civile.

Gjykata, pas çelë seancën e pajtimit,

VËREN:

Pala paditëse, Enkelejda Ago i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë me kërkesë padinë me objekt zgjidhjen e martesës ligjore me palën e paditur Ardian Ago.

Gjykata, pasi u njoh me kërkesëpandinë dhe aktet bashkëlidhur, konstatoi se kjo mosmarrëveshje bën pjesë në juridiksionin gjyqësor, referuar nenit 36 të Kodit të Procedurës Civile. Gjithashtu, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë është kompetente nga pikpamja lëndore, bazuar në nenin 41 e 349 shkronja "a" e K. Pr. Civile, si dhe nga pikpamja tokësore, bazuar në nenin 51 të K. Pr. Civile, si gjykata ku kanë vendbanimin e fundit të përbashkët bashkëshortët.

Pas marrjes së dosjes, gjykata në zbatim të nenit 134 të K. Familjes, ka planifikuar seancën pajtimore për në datë 15.12.2022.

Në zhvillimin e seancës pajtimore, gjykata mban parasysh rregullimin e saj nga neni 134 dhe 135 i K. Familjes.

Neni 134, ndër të tjera, parashikon: "*Në shqyrtimin e padisë për zgjidhjen e martesës, gjykata cakton fillimisht një seancë pajtimi, në të cilën duhet të paraqiten personalisht bashkëshortët. Gjyqtari mund t'i dëgjojë veçmas dhe më pas bashkërisht, pa praninë e përfaqësuesve të tyre.....*"

Neni 135 parashikon: "*Në rast se në seancën e pajtimit nuk paraqitet paditësi, ndonëse ka patur dijeni rregullisht, gjyqtari i vetëm vendos pushimin e gjykimit të çështjes. Kur nuk paraqitet i padituri, ndonëse ka patur dijeni rregullisht, gjyqtari shtyn seancën e pajtimit, duke i përsëritur njoftimin të paditurit. Nëse edhe në këtë seancë i padituri nuk paraqitet pa ndonjë shkak të arsyeshëm, gjyqtari, pasi dëgjon paditësin dhe krijon bindjen se pajtimi i bashkëshortëve nuk mund të arrihet, cakton seancën gjyqësore duke urdhëruar thirrjen e provave të nevojshme.*"

Në seancën pajtimore të datës 06.02.2023, rezultoi që nuk ishte paraqitur asnjë nga palët. Referuar fletëthirrjeve të njoftuara nga gjykata, paditësja kishte dijeni rregullisht për datën dhe orën e zhvillimit të seancës, ndërsa për të paditurin fletëthirrja ishte kthyer me shënimin "Larguar në Greqi".

Përsa më sipër, bazuar në nenin 135 të K. Familjes dhe nenin 179/1 të K. Pr. Civile, duke e konsideruar mungesën e paditëses në seancën pajtimore pa shkaqe të arsyeshme, megjithëse ka patur dijeni të rregullt për datën dhe orën e saj, gjykata, çmon se ndodhemi përpara rastit kur vendoset pushimi i gjykimit.

PËR KETO ARSYE:


Gjykata, bazuar në nenin 135 të K. Familjes dhe 179, 299/ç te K.Pr: Civile

VENDOSI:

- Pushimin e gjykimit të çështjes nr. regj. them. 21001-01877-41-2022(760/1537) datë 22.12.2022.
- Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Përgjithshme të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

U shpall në Korçë, me datë 06.02.2023.

SEKRETARE
Brilda HOXHALLARI



GJYQTARE
Gentiana SHUKULLARI

